



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 14
24.03.2017

NR. VENDIMI 11
28.03.2017

VENDIM
“Per zgjatjen e afatit te sekuestrimit”

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, e perbere prej:

GJYQTARE - MILIANA MUÇA

asistuar nga sekretare seance gjyqesore Jerina Skrapari, ne Tirane, sot me dt.28.03.2017, ora 10.30 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura kerkesen me nr.regj.themeltar 14, date 24.03.2017 qe i perket:

KERKUES: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles per Krime te Renda, e perfaqesuar ne gjykim nga prokurorja Sonila Muhametaj.

KUNDER: F.K, i datëlindjes XX.XX.XXXX, lindur në xxxxxx Fier dhe banues në xxxxxx xxxxxx Fier, si dhe kunder M.C dhe F.K.
M.C F.K

OBJEKTI: Zgjatje e afatit te sekuestrimit te pasurise te vendosur nga kjo gjykate me vendimin nr.22, date 28.10.2015.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Ne perfundim te hetimit gjyqesor, ne pretendimet perfundimtare, perfaqesuesja e pales kerkuese, Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, kerkoi pranimin e kerkeses, duke zgjatur afatin e sekuestros dhe dy muaj.

Gjykata, pasi shqyrtoi provat dhe analizoi ne teresi rrethanat e çeshtjes,

VEREN

Me urdherin date 21.10.2015, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane ka regjistruar procedimi pasuror nr.12 ne ngarkim te shtetasit F.K dhe te familjareve te tij. Regjistrimi i ketij procedimi eshte rezultat i dokumentacionit referues te Drejtorise se Policise se Qarkut Fier, te dhenave te Zyres Qendrore Kombetare te Interpol Tiranes drejtuar Ministrise se Drejtesise, nga ku rezulton:

Me vendimin nr.12423/01 R.G.P.M. - N.7835/01 R.G.G.I.P. date **26.11.2001** te Gjykates Penale Rome Itali per shtetasin shqiptar F.K eshte caktuar masa e sigurimit “arrest ne burg” per vepren penale te **“shoqate kriminale, trafikim, prodhim dhe posedim te lendeve narkotike”** denuar me 24 vjet burgim dhe me vendimin Nr.6886/98 R.G.N.R. - N. 3081/98

R.G.G.I.P. date **18.09.2000**, te Gjykates Penale Milano Itali eshte caktuar masa e “arrestit ne burg” per vepren penale te **“Pjesemarrjes ne organizata kriminale dhe shkelje te ligjit per narkotiket”** per te cilen eshte denuar me 16 vjet burgim.

Lidhur me kete procedim pasuror, me vendimin nr.22, date 28.10.2015 Gjykata per Krime te Renda Tirane, ka vendosur:

I. Pranimin e kerkeses se Prokurorise prane Gjykates e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.

II. Sekuestrimin e pasurive si me poshte:

1. Pasuria nr.X/XXX, ZK. XXXX, vol.XX fq.XXX, truall me sipërfaqe 4500 m², ndërtesë 1686 m², në emër të Znj.M.M.C.
2. Pasuria nr.XX/X me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 15.10.2010, pyll me sipërfaqe totale 580.000 m², ZK.XXXX në emër të Znj.M.C + F.A dhe L.L, pjesen qe M.C nga kjo pasuri 364.000 m².
3. Pasuria nr.X/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 09.03.2010, pyll me sipërfaqe 221.670 m², në emër të Znj.M.C.
4. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 09.03.2010, pyll me sipërfaqe 30.000 m², në emër të Znj. M.C.
5. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 09.03.2010, pyll me sipërfaqe 16.000 m², në emër të Znj.M.C.
6. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 09.03.2010, tokë pa frut me sipërfaqe 8600 m², në emër të Znj.M.C.
7. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 13.11.2009, tokë pa frut me sipërfaqe 24.000 m², në emër të Znj.M.C.
8. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 13.11.2009, tokë pa frut me sipërfaqe 14.000 m², në emër të Znj.M.C.
9. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, tokë pa frut me sipërfaqe 24.000 m², në emër të Znj.M.C.
10. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, tokë pa frut me sipërfaqe 89.000 m², në emër të Znj.M.C.

11. Pasuria nr.XX/XX, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 19.06.2010, tokë pa frut me sipërfaqe 12.500 m², në emër të Znj.M.C.
12. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 09.03.2010, tokë arë me sipërfaqe 9000 m², në emër të Znj.M.C.
13. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, tokë pa frut me sipërfaqe 4500 m², në emër të Znj.M.C.
14. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, pyll me sipërfaqe 207.700 m², në emër të Znj.M.C.
15. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, arë me sipërfaqe 72.200 m², në emër të Znj.M.C.
16. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, arë me sipërfaqe 54.200 m², në emër të Znj.M.C.
17. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 30.09.2009, tokë arë me sipërfaqe 3.000 m², në emër të Znj.M.C.
18. Pasuria nr.X/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 16.02.2010, tokë pyll me sipërfaqe 90.000 m², në emër të Znj.M.C.
19. Pasuria nr.X/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 16.02.2010, tokë pyll me sipërfaqe 11.440 m², në emër të Znj.M.C.
20. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 13.11.2009, tokë pa frut me sipërfaqe 11.440 m², në emër të Znj.M.C.
21. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 13.11.2009, tokëe pa frut me sipërfaqe 1.000 m², në emër të Znj.M.C.
22. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 23.11.2010, tokë inproduktive me sipërfaqe 840.000 m², në emër të Znj.M.C.
(te gjitha te regjistruara prane Zyres Vendore te Regjistrimit te Paluajtshme Fier).

- Sekuestrimin shoqerive tregtare dhe aseteve si më poshtë vijon:

1. Shoqërinë “XXXXXXXXXX”, sh.p.k, me (NIPT) XXXXXXXXXXXX, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr.Vendimi 30975, datë 10.02.2004 Kapitali: 100.000.
2. Shoqërinë “XXX 2011”, sh.p.k, me (NIPT) XXXXXXXXXXXX, e regjistruar në QKR. Kapitali: 100.000.
3. Ne pjesën që i takon shtetasit F.K, në shoqërinë “XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX XXXXXXXX 2011”, sh.p.k me (NIPT) XXXXXXXXXXXX, e regjistruar në QKR.

III. Për Administrimin e pasurive te sekuestruara ngarkohet Z.Bedri Buzo, administrator ne Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

IV. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Fier.

Kunder ketij vendimi rezulton te jete ushtruar ankim nga te hetuarit F.K, F.K dhe M.C dhe Gjykata e Apelit per Krime te Renda me vendimin nr.84, date 28.12.2015 ka lene ne fuqi vendimin nr.22, date 28.10.2015.

Me vendimin gjyqesor nr.7, date 24.05.2016 Gjykata per Krime te Renda Tirane, ka pranuar kerkesen e Prokurorise, duke zgjatur afatin e zbatimit te mases se sekuestros si mase parandaluese me karakter pasuror, e caktuar me vendimin gjyqesor nr.22, date 28.10.2015 per nje periudhe tre mujore, deri me date 01.09.2016.

Me vendimin gjyqesor nr.16, date 29.08.2016 Gjykata per Krime te Renda Tirane, ka pranuar kerkesen e Prokurorise, duke zgjatur afatin e zbatimit te mases se sekuestros si mase parandaluese me karakter pasuror, e caktuar me vendimin gjyqesor nr.22, date 28.10.2015 per nje periudhe tjeter tre mujore.

Me vendimin nr.23, date 25.11.2016 Gjykata per Krime te Renda Tirane, ka pranuar kerkesen e Prokurorise, duke zgjatur afatin e zbatimit te mases se sekuestros si mase parandaluese me karakter pasuror, e caktuar me vendimin gjyqesor nr.22, date 28.10.2015, e zgjatur me vendimin nr.7, date 24.05.2016 dhe nr.16, date 29.08.2016, dhe per nje periudhe tre mujore.

Me vendimin nr.5, date 22.02.2017 Gjykata per Krime te Renda Tirane, ka pranuar kerkesen e Prokurorise, duke zgjatur afatin e zbatimit te mases se sekuestros dhe per nje periudhe nje mujore, duke saktësuar se ky afat perfundon me date 01.04.2017 (ne te gjithe keto vendime kane gjetur pasqyrim dhe veprimet hetimore te kryera ne kuader te hetimit pasuror, duke u paraqitur si prove nga ana e prokurorise vetem vendimi nr.5, date 22.02.2017).

Me date 24.03.2017, prokuroria prane kesaj gjykate ka paraqitur nje kerkese tjeter per zgjatjen e afatit te zbatimit te mases se sekuestros me afat dy muaj.

Ne kerkesen per zgjatjen e afatit te sekuestrimit, prokurorja, pervecse parashtrohen rrethanat e nisjes se procedimit pasuror ndaj shtetasit F.K (te cilat gjejne pasqyrim dhe ne vendimin nr.22, date 28.10.2006 dhe personave ne zoterim te pasurise se sekuestruar, me prejardhje te dyshuar kriminale, argumenton:

“ Referuar dokumentacionit te administruar nga Z.V.R.P.Palujtshme Fier, njera prej pasurive truall + ndertese, ajo me numer x/xxx, eshte vendosur kolateral ne shlyerjen e nje kredie ne shumen 430 mije euro, me krediamarres shoqeria “ xxxxxx “ Sh.P.K., dorezanes F.K. Nepermjet disa kontratave rezulton se shuma totale e kredise eshte 430 mije euro. Per nevoja te hetimit pasuror eshte kerkuar dhe informacion nga Tirana Bank, nese kjo kredi bankare eshte shlyer dhe kur. Ky informacion deri ne kete faze te hetimit nuk eshte siguruar.Gjithashtu, argumentohet se nuk eshte bere i mundur ende adminstrimi i plote i akteve te ekspertimit te seciles prej pasurive “.

Mbi keto argumenta, pretendohet kompleksiteti i hetimit pasuror dhe nevojshmeria e zgjatjes se afatit te sekuestros dhe me dy muaj, duke marre ne konsiderate dhe zgjatjen e sekuestros me vendimet nr.7, date 24.05.2016; nr.16, date 29.08.2016; nr.23, date 25.11.2016; nr. 5 date 22.02.2017, afat qe perfundon me date 01.04.2017.

Lidhur me kete kerkese, **kjo gjykate çmon se ajo eshte e bazuar ne ligj dhe gjen mbeshtetje dhe ne prova qe perligjin ate çka parashikon ligji i posaçem nr.10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.**

Neni 12 i këtij ligji parashikon:

- “1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata, me pjesëmarrjen e prokurorit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij.*
- 2. Vendimi për masën e sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij. Masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj.*
- 3. Në rastin e verifikimeve komplekse, me kërkesë të prokurorit, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit për periudha tremujore, por jo më shumë se një vit nga data e mbarimit të afatit të masës së sekuestrimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në një gjykatë të një niveli më të lartë.*
- 4. Kur masa e sekuestrimit caktohet ndaj pasurive të paluajtshme ose pasurive të regjistruara në regjistra publikë, administratori i emëruar bën menjëherë njoftimin e kësaj mase në zyrat, pranë të cilave mbahen këta regjistra.*
- 5. Prokurori, jo më vonë se 5 ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit, të parashikuar në pikën 2 ose 3 të këtij neni, mund të paraqesë kërkesë për konfiskimin, e pasurisë ose zgjatjen e afatit të masës së sekuestros. Në rast të kërkesës për konfiskim, masa e sekuestrimit vazhdon deri në përfundimin e gjykimit për konfiskimin e pasurisë.*
- 6. Mosparaqitja e kërkesës, sipas pikës 5 të këtij neni, passjell shuarjen e masës së sekuestrimit. Megjithatë, shuarja e sekuestrimit nuk pengon paraqitjen dhe pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë”.*

Fillimisht, kjo gjykatë arsyeton se afati i zgjatur i masës së sekuestrimit me vendimin nr.23, date 25.11.2016, sikurse dhe është saktësuar në vendimin nr. 5 date 22.02.2017, përfundon me date 01.04.2017 dhe paraqitja e kërkesës për zgjatjen e masës së sekuestrimit me date 24.03.2017 është brenda afatit të parashikuar në pikën 5 të nenit të sipërcituar, 5 ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit.

Persa i perket thelbit të kerkimit për zgjatjen serish të afatit të zbatimit të masës së sekuestros me dy muaj, kjo gjykatë, sikurse ka argumentuar dhe në vendimet e zgjatjes së masës së sekuestros nr.7, date 24.05.2016; nr.16, date 29.08.2016, nr.23, datë 25.11.2016; nr. 5 date 22.02.2017 vlereson se kemi të bëjmë me një hetim pasuror të një natyre shumë komplekse, çka perben dhe kushtin ligjor të nenit 12 pika 2 të sipërcituar për zgjatjen e afatit të masës së sekuestros. Behet fjale për një numër të konsiderueshëm pasurish të paluajtshme, si dhe sekuestrimin e tre shoqërive tregtare.

Me date 23.09.2016, është urdheruar dhe kryerja e ekspertimit vlerësues të pasurive dhe ky fakt ka gjetur trajtim dhe në vendimet paraardhëse me të cilat dhe është zgjatur afati i sekuestros. Pavaresisht se i njëjti argument (mosadministrimi i aktit të ekspertimit vlerësues) është përdorur nga prokurorja dhe është vlerësuar nga gjykata në këto vendime, karakteri i çështjes, numri i pasurive që duhen vlerësuar, janë rrethana të tilla që justifikojnë mospërfundimin e ekspertimit brenda afatit të zgjatur, që përfundon më datë 01.04.2017.

Rezulton se nga ana e oficerit te policise gjyqesore eshte pyetur me cilesine e personit ndaj te cilit zhvillohen hetime eksperti A. K. rreth shkaqeve te voneses se dorezimit te aktit te ekspertimit dhe ka sqaruar keto rrethana (qe lidhen me venien me vonese ne dispozicion te dokumentacionit te dy prej pasurive).

Gjithashtu u paraqit si prove dhe shkresa nr. 724 prot. date 24.03.2017 me te cilen, prokurorja dhe i eshte drejtuar Tirana Bank per plotesimin e pergjigjes qe ajo kishte percjelle me shkesen e dates 10.03.2017 (ku nuk sqarohet nese kredia ishte shlyer apo jo, qofte dhe pjeserisht, informacion ky qe dhe nga kjo gjykate vleresohet i domosdoshem ne kuader te hetimit pasuror te regjistruar.

Ne perfundim, gjykata **konkludon se periudha kohore e zgjatjes se mases se sekuestrimit, zgjatje e dhene me vendimin nr.5, date 22.02.2017, eshte mireadministruar nga pala kerkuese dhe veprimet hetimore te nisura, siç eshte ekspertimi vleresues i pasurive ne pronesi apo zoterim te subjekteve te hetimit pasuror, sigurimi i informacionit mbi shlyerjen e kredise se marre nga subjektet e hetuar, duke u vendosur si kolateral njera prej pasurive te sekuestruara, jo vetem çmohen te nevojshme nga kjo gjykate ne kuader te hetimit pasuror, por dhe te tilla qe kerkojne nje kohe te caktuar per t'u permbushur.**

Per pasoje kerkesa e prokurorise prane kesaj gjykate per zgjatjen serish, kete radhe me afat dy muaj, te afatit te mases se sekuestrimit per pasurite per te cilat eshte vendosur kjo mase me vendimin gjyqesor nr.22, date 28.10.2015, afat ky i zgjatur dhe me vendimin nr.7, date 24.05.2016; nr.16, date 29.08.2016, nr.23, date 25.11.2016, nr. 5. date 22.02.2017, duhet pranuar.

Perfshire dhe kete afat plotesohet afati maksimal i lejuar nga pika 3 e nenit 5 te ligjit te posaçem, sipas te cilit zgjatja e afatit te zbatimit te mases se sekuestrimit nuk mund te jete me shume se nje vit nga data e mbarimit te afatit te mases se sekuestrimit (masa e sekuestrimit eshte e vlefshme per nje periudhe gjashtemujore, duke filluar nga momenti i zbatimit te saj).

Ne zbatim te nenit 15 pika 1 te ligjit, gjykata ne vendimin e sekuestrimit te pasurise, ka detyrimin te caktojë dhe administratorin, referuar listes se administratoreve te Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te konfiskuara. Eshte caktuar si administrator Z.Bedri Buzo, i cili do te vijojë administrimin dhe perdorimin e pasurive te sekuestruara.

Ne referim te nenit 14 pika 2 te ligjit, vendimi per zgjatjen e sekuestrimit te pasurise, sikurse dhe vendimi i mases se sekuestrimit duhet t'i komunikohet zoteruesit/zoteruesve te pasurise se sekuestruar. Ne rastin konkret, dhe vendimi per zgjatjen e afatit te mases se sekuestrimit duhet t'i njoftohet jo vetem shtetasi F.K, por dhe shtetasve M.C dhe F.K. Njoftimi do te behet ne respektim te kerkesave te neneve 130-133 te K.Pr.Civile (neni 14 pika 2).

Lidhur me te drejten e ankimit kunder vendimit per zgjatjen e afatit te sekuestrimit (sikurse dhe vendimit te mases se sekuestrimit), ligji, ne nenin 27 pika 1 ka parashikuar te drejten e

ankimit sipas afateve dhe kushteve te parashikuara ne Kodin e Procedures Civile, ankim qe nuk pezullon zbatimin e vendimit.

Ne referim te nenit 443/2 te K.Pr.Civile, afati i ankimit ne Gjykatën e Apelit eshte 15 dite. Per shtetasit F.K, M.C dhe F.K, ky afat fillon nga e nesermja e komunikimit.

PER KETO ARSYE.

Gjykata, bazuar ne nenet 12, 14, 15, 27 te ligjit nr.10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, nenet 126, 306-310 te K.Pr.Civile,

VENDOSI

I. Pranimin e kerkeses se Prokurorise prane Gjykates e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.

II. Zgjatjen e afatit te zbatimit te mases se sekuestros si mase parandaluese me karakter pasuror, e caktuar me vendimin gjyqesor nr.22, date 28.10.2015, e zgjatur me vendimet nr.7, date 24.05.2016; nr.16, date 29.08.2016; nr.23, datë 25.11.2016, nr.5, date 22.02.2017 dhe per nje periudhe dy mujore, afat që perfundon me date 01.06.2017, per pasurite:

1. Pasuria nr.X/XXX, ZK.XXXX, vol.XX fq.XXX, truall me sipërfaqe 4500 m², ndërtesë 1686 m².
2. Pasuria nr.XX/X me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 15.10.2010, pyll me sipërfaqe totale 580.000 m², ZK.14XX.
3. Pasuria nr.X/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 09.03.2010, pyll me sipërfaqe 221.670 m².
4. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 09.03.2010, pyll me sipërfaqe 30.000 m².
5. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 09.03.2010, pyll me sipërfaqe 16.000 m².
6. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor datë 09.03.2010, tokë pa frut me XX, sipërfaqe 8600 m².
7. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor datë 13.11.2009, tokë pa frut me XXX, sipërfaqe 24.000 m².
8. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor datë 13.11.2009, tokë pa frut me XXX, sipërfaqe 14.000 m².
9. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor datë 09.03.2010, tokë pa frut me XXX, sipërfaqe 24.000 m².
10. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor datë 09.03.2010, tokë pa frut me XXX, sipërfaqe 89.000 m².
11. Pasuria nr.XX/XX, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 19.06.2010, tokë pa frut

me sipërfaqe 12.500 m^2 .

12. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 09.03.2010, tokë arë me sipërfaqe 9000 m².
 13. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, tokë pa frut me sipërfaqe 4500 m².
 14. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, pyll me sipërfaqe 207.700 m².
 15. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, arë me sipërfaqe 72.200 m².
 16. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 09.03.2010, arë me sipërfaqe 54.200 m².
 17. Pasuria nr.XXX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 30.09.2009, tokë arë me sipërfaqe 3.000 m².
 18. Pasuria nr.X/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 16.02.2010, tokë pyll me sipërfaqe 90.000 m².
 19. Pasuria nr.X/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XX, datë 16.02.2010, tokë pyll me sipërfaqe 11.440 m².
 20. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 13.11.2009, tokë pa frut me sipërfaqe 11.440 m².
 21. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 13.11.2009, tokë pa frut me sipërfaqe 1.000 m².
 22. Pasuria nr.XX/X, ZK.XXXX me nr.Regj.Hipotekor XXX, datë 23.11.2010, tokë inproduktive me sipërfaqe 840.000 m².
- (te gjitha te regjistruara prane Zyres Vendore te Regjistrimit te Paluajtshme Fier).
- **shoqerive tregtare dhe aseteve si më poshtë vijon:**
- 1.- Shoqërinë “XXXXXXXXXX”, sh.p.k, me (NIPT) XXXXXXXXXXXX, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr.Vendimi 30975, datë 10.02.2004 Kapitali: 100.000.
 2. Shoqërinë “XXX 2011”, sh.p.k, me (NIPT) XXXXXXXXXXXX, e regjistruar në QKR. Kapitali: 100.000.
 3. Ne pjesën që i takon shtetasit F.K, në shoqërinë “XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX XXXXXXXX 2011”, sh.p.k me (NIPT) XXXXXXXXXXXX, e regjistruar në QKR.

III. Për Administrimin dhe perdorimin e pasurive te sekuestruara ngarkohet Z.Bedri Buzo, administrator ne Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

IV. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Fier.

V. Urdhërohet kryesekretaria prane kesaj gjykate qe t’iu njoftoje shtetasve F.K, M.C dhe F.K, si dhe institucioneve te mesiperme vendimin e zgjatjes se afatit te zbatimit te mases se sekuestros.

VI. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda Tirane.

Per shtetasit F.K, M.C dhe F.K, ky afat fillon nga e nesermja e komunikimit te vendimit.

U shpall ne Tirane sot me dt.28.03.2017, ora 10.55.

SEKRETARE
JER SKRAPARI

GJYQTARE
MILIANA MUÇA

